



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes :	71041-01431-11-2019	Data e Regjistrimit :	23/05/2019
Numri i Vendimit:	11-2019-4727	Data e Vendimit :	06/09/2019

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Rexhep Bekteshi

SEKRETARE: Brunilda Dizdari

Sot më datë 06/09/2019mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues Skënder Turku {...}, i biri i {...} dhe i x, i datëlindjes {...}

Objekti:Heqjen e sekuestros preventive mbi per shumat e parave te ndodhura ne llogarite me Nr. {...} e Nr. {...} ne emer të kërkuesit {...} te depozituara ne {...} Bank Tirane.

Baza Ligjore:Neni 274 panagrafi 3 i Kodit te Procedures Penale.

Në gjykim mori pjesë **Prokurorja e çështjes Enkeleda Xhengo.**

Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes si dhe provat e marra në gjykim e në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dëgjoi kërkuesin {...} dhe avokaten mbrojtëse të tij që i kërkuan Gjykatës: Pranimin e kërkesës dhe heqjen e sekuestrimit të llogarive bankare me Nr. {...} e Nr. {...}, në emër të kërkuesit {...} të depozituara në {...} Bank Tiranë, të vendosura me Vendimin penal Nr. 136, datë 17.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në zbatim të neneve 212, 274 e vijues të Kodit Procedurës Penale.

Prokurorja e çështjes Enkeleda Xhengo në përfundim të shqyrtimit gjyqësor deklaroi se nga akti i ekspertimit kontabël të ekspertit kontabël {...}i gjatë hetimit të çështjes penale ka rezultuar se shtetasi {...}dhe {...} me të ardhurat e tyre mundeshin të realizonin shpenzimet për blerjen e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme e depozitim e shumave në bankë.

Për shkakun e mësipërm prokurorja e çështjes shtoi që kërkesa e bërë nga kërkuesi {...} për heqjen e sekuestrimit të llogarive bankare me Nr {...} e Nr. {...}, pranë {...}

Bank-Tiranë është e mbështetur në prova e ligj dhe i kërkoi Gjykatës të pranojë kërkesën e bërë nga shtetasi {...}.

Gjykata pasi shqyrtoi materialet e çështjes,

VEREN :

Vëren:

Se nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës po kryhen hetime për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" që parashikohet nga neni 287 i Kodit Penal ndaj shtetasve {...}, që nga hetimi del se është përfshirë dhe në veprimtarinë e paligjshme të trafikimit të lëndëve narkotike.

Gjatë fazës së hetimeve paraprake mbi bazën e kërkesës të organit të hetimit me Vendimin penal Nr. 136, datë 17.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur:

-Vendosjen e sekuestros preventive për shumën e parave të ndodhura në llogaritë Nr. {...} dhe Nr. 0000808743, në emër të {...} të depozituara në {...} Bank Tiranë, si dhe të llogarive me Nr. {...} e Nr. {...}, në emër të shtetasit {...}u të depozituara në {...} Bank-Tiranë.

Vendimi penal i mësipërm është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me Vendimin penal Nr. 30, datë 21.02.2018 dhe është zbatuar nga Prokuroria.

Nga hetimet e kryera del se {...} është babai i {...} e ka llogari bankare me Nr.

{...}, në shumën {...} lekë dhe llogari bankare me Nr. {...} në shumën

{...} lekë të depozituara në {...} Bank-Tiranë, që janë të sekuestruara.

Shtetasi {...} ka paraqitur në Gjykatë kërkesën me objekt: Heqjen e sekuestros preventive (zhbllokimin) për dy llogaritë bankare të mësipërme duke pretenduar se shumatat e mësipërme janë të ligjshme e nuk kanë lidhje me ndonjë aktivitet të kundërligjshëm e se i nevojiten për arsye shëndetësore, pasi bashkëshortja e tij është invalide dhe me probleme shëndetësore.

Nga materialet e paraqitura në gjykim prej prokurores së çështjes del se gjatë hetimeve të mëtejshme, për sqarimin e rrethanave të çështjes është administruar akti i ekspertimit teknik kontabël i ekspertit {...}i, që ka konkluduar se me të ardhurat e ligjshme kërkuesi {...} e shtetasja

{...} realizojnë shpenzimet për blerjen e pasurive të paluajtshme e të luajtshme, si dhe

depozitim të shumës prej {...} lekë në llogarinë Nr. {...} dhe të shumës prej {...}

lekë të depozituar në llogarinë bankare me Nr. {...}, në {...} Credit Bank-Tiranë.

Akti i ekspertimit kontabël përkatës u administrua nga Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe prokurorja e çështjes Enkeleda Xhengo, në gjykim i kërkoi Gjykatës që të pranojë kërkesën e bërë nga kërkuesi {...}, për heqjen e sekuestros preventive mbi shumatat e lekëve të depozituara në llogaritë bankare me Nr. {...}1 dhe Nr. {...}, në {...} {...} Bank-Tiranë.

Gjykata analizoi të gjithë provat e faktet dhe konkludon se kërkesa e bërë nga kërkuesi {...} për heqjen e sekuestros preventive të vendosur me Vendimin penal Nr. 136, datë 17.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shumatat e lekëve prej {...} lekë e depozituar në llogarinë Nr. {...}1 dhe të shumës prej {...} lekë e depozituar në llogarinë bankare me Nr.

{...}, në {...} Credit Bank-Tiranë është e mbështetur në prova e ligj dhe duhet pranuar.

Për këto arsye

Baza Ligjore:

Në zbatim të neneve 212, 274 e 276 të Kodit Procedurës Penale, Gjykata:

VENDOSI:

Vendosi:

1.Heqjen e sekuestros preventive të vendosur me Vendimin penal Nr. 136, datë 17.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vetëm për shumatat e lekëve të depozituara në llogaritë bankare me Nr. {...} dhe Nr. {...}, në emër të shtetasit (kërkuetit) {...}e të depozituara në {...} Bank Tiranë.

2.Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij.

U shpall sot më datë 06.09.2019.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia

0

Taksa Gjyqësore

200

Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	200

GJYQTAR:
Rexhep Bekteshi